



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0328

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “HM Home” SH.P.K. kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar ne qendra te ndryshme sociale” me numër të prokurimit:616-26-2558-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Prishtines më 22/06/2026, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE “HM Home” SH.P.K.me nr. 2026/0328, e datës 19/05/2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar ne qendra te ndryshme sociale”me numër të prokurimit:616-26-2558-1-2-1, ndërsa (AK) Komuna e Prishtines i lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

2.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Prishtines në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar ne qendra te ndryshme sociale” me numër të prokurimit: 616-26-2558-1-2-1.

Me13.05.2026 OE “HM Home” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si te pa bazuar.

OSHP ka pranuar ankesën nga OE “HM Home” SH.P.K. me nr. 0328/2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar ne qendra te ndryshme sociale” me numër të prokurimit: 616-26-2558-1-2-1

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “HM Home” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prishtinës, ka publikuar njoftimin për kontratë me titull:

“Furnizim me inventar në qendra të ndryshme sociale”, me numër të prokurimit 616-26-2558-1-2-1.

Pas shkarkimit dhe shqyrtimit të njoftimit, kemi konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka paraqitur disa kërkesa kualifikimi, të cilat haptazi favorizojnë ndonjë operator ekonomik të paracaktuar. Pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit dhe kërkesave të përcaktuara lidhur me kapacitetin ekonomik, teknik dhe profesional, konsiderojmë se një pjesë e madhe e kriterëve të vendosura janë joproporcionale me natyrën e kontratës dhe në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, duke kufizuar konkurrencën e lirë dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, pika 2, është kërkuar që OE ofertues të caktojë një Menaxher të Projektit, i cili duhet të jetë dizajner i enterierit, inxhinier i diplomuar ose me gradë Master, me së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Gjithashtu, OE duhet të emërojë me vendim Menaxherin e Projektit dhe të dëshmojë përvojën e tij me CV, diplomë dhe dokumentacion përkatës.

Këtë kërkesë e kundërshtojmë, pasi objekti i kontratës ka të bëjë me furnizim me mobilie dhe jo me projektim profesional të enterierit apo shërbime arkitektonike. Kjo kërkesë është joproporcionale me natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe kufizon konkurrencën duke favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar që posedojnë staf specifik profesional, i cili nuk është i domosdoshëm për realizimin e kontratës. Andaj, kërkojmë që kjo kërkesë të hiqet.

Lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, pika 3, OE ofertues duhet të ketë një Inxhinier të Emergjencave, të diplomuar ose me gradë Master, me së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit, i cili duhet të jetë i certifikuar si ekspert për siguri dhe

shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri. Kjo duhet të dëshmohet me kopje të diplomës, kontratë pune ose marrëveshje për këtë projekt, CV të nënshkruar dhe certifikatat përkatëse.

Edhe këtë kërkesë e kundërshtojmë, pasi nuk ka lidhje me natyrën e kontratës, e cila ka të bëjë me furnizim me mobilie. Kjo kërkesë është joproporcionale, diskriminuese dhe e panevojshme për realizimin e kontratës, pasi furnizimi dhe montimi i mobilieve nuk përbën aktivitet teknik apo industrial që kërkon angazhimin e një eksperti të emergjencave apo specialisti për mbrojtje nga zjarri. Vendosja e kësaj kërkesë kufizon konkurrencën dhe bie ndesh me parimet e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Për këto arsye, ky kriter duhet të hiqet menjëherë.

Lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, pika 4, OE ofertues duhet të ketë së paku pesëmbëdhjetë (15) punëtorë ndihmës të angazhuar për këtë projekt, të trajnuar për siguri dhe shëndet në punë, me certifikata valide, si dhe pesë (5) punëtorë të trajnuar për mbrojtje nga zjarri, gjithashtu me certifikata valide. Duhet të prezantohen certifikatat përkatëse, lista e punëtorëve dhe licenca e kompanisë që ka kryer trajnimin.

Këtë kërkesë e kundërshtojmë në tërësi, pasi është skajshmërisht joproporcionale, diskriminuese dhe në kundërshtim me natyrën reale të aktivitetit të prokurimit. Objekti i kësaj kontrate ka të bëjë me furnizim me mobilie dhe nuk paraqet projekt ndërtimor, industrial apo aktivitet teknik me shkallë të lartë rrezikshmërie që do të arsyetonte kërkesa kaq të rënda dhe të ekzagjeruara lidhur me numrin e stafit të trajnuar për siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri.

Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim objektiv dhe proporcional se përse për realizimin e një kontrate furnizimi me mobilie nevojiten 15 punëtorë të certifikuar për siguri në punë dhe 5 punëtorë shtesë të certifikuar për mbrojtje nga zjarri. Kjo kërkesë tejkalon dukshëm nevojën reale të kontratës dhe krijon barriera artificiale për pjesëmarrje, duke kufizuar konkurrencën e lirë dhe duke favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar që posedojnë struktura të mëdha organizative, pa pasur kjo lidhje me cilësinë e furnizimit.

Po ashtu, kërkesa për certifikime masive të stafit përbën barrë të panevojshme administrative dhe financiare për operatorët ekonomikë, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duke cenuar drejtpërdrejt parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik. Kjo kërkesë nuk është në harmoni me objektin e kontratës dhe nuk ndikon në mënyrë reale në aftësinë e operatorit ekonomik për të furnizuar mobilet e kërkuara. Për rrjedhojë, ajo duhet të hiqet menjëherë.

Lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, pika 5, OE duhet të ofrojë dëshmi nga prodhuesi (apo dileri) për standardet ISO si në vijim: ISO 10002:2018, ISO TC 136, ISO 19682:2023, ISO 10204, EN 1335-1, EN 1090-1:2009+A1:2011, TS EN 10204:2007 dhe TS ISO 21524:2021. Dëshmia duhet të paraqitet përmes kopjeve të certifikatave përkatëse.

Këtë kërkesë e kundërshtojmë në mënyrë të prerë, pasi këto standarde, në mënyrën si janë vendosur në Dosjen e Tenderit, janë të paarsyeshme, të shpërndara në mënyrë të pakonsoliduar dhe, në pjesën më të madhe të tyre, nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën e kontratës, e cila ka të bëjë me furnizim të thjeshtë me mobilie.

Këto standarde i përkasin fushave të ndryshme teknike dhe industriale, si menaxhimi i proceseve të cilësisë, strukturat metalike dhe inxhinierike, sistemet teknike të specializuara, dokumentimi

technik dhe proceset laboratorike, fusha të cilat tejkalojnë dukshëm furnizimin standard me mobilie. Vendorsja e tyre si kërkesë obligative për pjesëmarrje në tender krijon një pengesë të pajustificuar dhe artificiale për operatorët ekonomikë, duke kufizuar konkurrencën e lirë dhe duke eliminuar nga pjesëmarrja një numër të madh operatorësh të kualifikuar që realisht janë të aftë të realizojnë kontratën.

Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur të dëshmojë lidhjen funksionale dhe proporcionale ndërmjet këtyre certifikimeve dhe objektit të kontratës, gjë që përbën shkelje të parimeve themelore të prokurimit publik, veçanërisht të parimit të proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Për këto arsye, kërkojmë që kjo kërkesë të hiqet në tërësi nga Dosja e Tenderit, si kërkesë e panevojshme, joproporcionale dhe kufizuese.

Lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, pika 6, OE ofertues duhet të posedojë: një (1) kamion transportues, një (1) furgon transportues dhe një (1) pickup. Për këtë duhet të paraqitet lista e pajisjeve, mjeteve dhe makinave teknike, si dhe dëshmi mbi pronësinë ose marrjen me qira të tyre. Gjithashtu kërkohen fotografi, specifikacione teknike, librezat dhe dokumentacion tjetër përkatës.

Këtë kërkesë e kundërshtojmë në mënyrë të prerë, pasi kërkesa për posedimin e detyrueshëm të automjeteve specifike të transportit, si kamion, furgon dhe pickup, është e paarsyeshme, joproporcionale dhe nuk është në përputhje me natyrën reale të kontratës, e cila ka të bëjë me furnizim me mobilie dhe jo me ofrimin e shërbimeve të transportit si aktivitet kryesor ekonomik.

Vendorsja e detyrimit për posedimin e drejtpërdrejtë të një flote të tillë automjeteve paraqet kufizim artificial të konkurrencës dhe eliminon nga pjesëmarrja operatorët ekonomikë që janë plotësisht të aftë për realizimin e kontratës përmes zgjidhjeve normale të tregut, si nënkontraktimi apo marrëveshjet logjistike.

Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar asnjë arsyetim objektiv dhe të bazuar në nevojë reale se përse për furnizimin dhe transportin e mobilieve kërkohet posedimi i domosdoshëm i:

- kamionit transportues;
- furgonit transportues;
- pickup-it.

Këto shërbime, në praktikë, mund të realizohen në mënyrë më fleksibile, më efikase dhe më ekonomike edhe pa posedimin e drejtpërdrejtë të mjeteve nga vetë operatori ekonomik. Kjo kërkesë krijon barriera të panevojshme për hyrje në treg, duke favorizuar vetëm kompani të mëdha që posedojnë asete të tilla në pronësi dhe duke diskriminuar operatorët ekonomikë të mesëm dhe të vegjël, të cilët mund ta realizojnë kontratën në mënyrë të plotë dhe profesionale përmes organizimit normal të zinxhirit të furnizimit.

Për më tepër, një kërkesë e tillë bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe me parimin e konkurrencës së lirë, pasi e shndërron një kontratë furnizimi në një garë posedimi asetesh, gjë që nuk është qëllim i Ligjit për Prokurimin Publik. Në këtë kontekst, kërkohet që kjo kërkesë të hiqet në tërësi nga Dosja e Tenderit, pasi është kufizuese, diskriminuese dhe nuk ka asnjë lidhje të domosdoshme me aftësinë reale të operatorit ekonomik për ta realizuar kontratën me sukses.

Lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, pika 8, OE ofertues duhet të dorëzojë planin dinamik të detajuar për secilin pozicion. Si dëshmi kërkohet plani dinamik i detajuar, i vulosur dhe i nënshkruar.

Këtë kërkesë e kundërshtojmë në mënyrë të prerë, pasi është e ekzagjeruar, joproporcionale dhe nuk ka asnjë lidhje reale me natyrën e kontratës, e cila ka të bëjë me furnizim me mobilie. Një plan dinamik i detajuar për secilin pozicion është instrument tipik i përdorur në kontrata të punimeve ndërtimore, inxhinierike apo projekte komplekse infrastrukturore, ku ekzistojnë faza të shumta ekzekutimi, varësi teknike ndërmjet aktiviteteve dhe afate të ndërthurura zbatimi.

Në rastin konkret, kontrata është kontratë furnizimi standard me mobilie, ku aktivitetet kryesore janë prodhimi, transporti dhe dorëzimi, pa procese të ndërlikuara të menaxhimit të fazave të punës. Vendosja e kësaj kërkesë në këtë formë përbën:

- formalizëm të tepruar administrativ;
- barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë;
- kusht artificial që nuk ndikon në cilësinë apo aftësinë reale për realizimin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar në asnjë mënyrë se si një plan kaq i detajuar për secilin pozicion ndikon në përmirësimin e ekzekutimit të një kontrate furnizimi, duke e bërë këtë kërkesë qartazi joproporcionale dhe jofunksionale. Për më tepër, një kërkesë e tillë nuk i shërben as transparencës dhe as menaxhimit të kontratës, por vetëm rrit kompleksitetin e panevojshëm të ofertimit dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që realisht kanë kapacitet për furnizimin e kërkuar.

Për këto arsye, kërkojmë që kjo kërkesë të hiqet në tërësi nga Dosja e Tenderit, pasi është e panevojshme, e tepruar dhe në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit, efikasitetit dhe konkurrencës së lirë në prokurimin publik.

Kontrata në fjalë ka të bëjë me furnizim me mobilie/interier dhe jo me punime teknike të natyrës së “teknikës së bardhë”, sistemeve TV, instalimeve teknike apo projekteve të inxhinierisë së avancuar. Për këtë arsye, një numër i konsiderueshëm i kriterëve të vendosura në Dosjen e Tenderit nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës dhe tejkalojnë dukshëm nevojën reale të Autoritetit Kontraktues (AK).

Këto kërkesa, të cilat duken të hartuara për një profil specifik operatori ekonomik, krijojnë barriera artificiale për hyrje në treg dhe cenojnë rëndë parimin e barazisë.

Duke marrë parasysh natyrën e furnizimit, kjo kontratë do të duhej të realizohej përmes mini-konkurrencës në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese të AQP-së. Ky veprim jo vetëm që do të kursente mjetet e buxhetit publik, por do të siguronte edhe një proces transparent dhe efikas. Përkundrazi, vendosja e kriterëve specifike dhe të panevojshme teknike vetëm sa kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të kualifikuar, duke e shndërruar procedurën në një proces selektiv dhe jokonkurues.

Duke u mbështetur në argumentet e mësipërme, kërkojmë zyrtarisht:

- largimin e menjëhershëm të kriterëve diskriminues dhe joproporcionale;

- heqjen e çdo kërkesë që nuk shton vlerë në cilësinë e furnizimit, por shërben vetëm si mjet eliminues;

- harmonizimin e kërkesave me natyrën reale të kontratës, në mënyrë që specifikimet teknike të pasqyrojnë nevojën reale të AK-së pa e ngarkuar procesin me certifikime apo kapacitete që nuk janë relevante për ekzekutimin e kontratës;

- respektimin e parimeve themelore të LPP-së, veçanërisht të Nenit 7 (Barazia në Trajtim/Mosdiskriminimi) dhe Nenit 6 (Ekonomia, Efikasiteti dhe Efektiviteti), të cilat përbëjnë shtyllat themelore të një sistemi të shëndoshë të prokurimit publik;

- rishikimin e plotë të procedurës së prokurimit, në përputhje me praktikat e AQP-së, duke krijuar mundësi për konkurrencë të lirë, të drejtë dhe pa privilegje të paracaktuara.

Autoriteti Kontraktues ka detyrim ligjor të sigurojë që procedura të zhvillohet në mënyrë të paanshme, transparente dhe konkurruese. Mosveprimi në këtë drejtim vetëm sa do të rëndonte më tej dyshimet për kurdisje dhe do të cenonte ligjshmërinë e të gjithë procesit të prokurimit.

Ne kemi dorëzuar kërkesën pranë Autoritetit Kontraktues më datë 13.05.2026 për heqjen e kritereve diskriminuese. Mirëpo, Autoriteti Kontraktues nuk ka kthyer asnjë përgjigje, duke shkelur rregullat dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik.

Për këtë arsye, më datë 19.05.2026 paraqesim ankesë në OSHP, pasi mosnxjerrja e një vendimi apo mosdhënia e një përgjigjeje përbën shkelje flagrante të ligjit. Andaj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të sanksionohet për këtë shkelje.

Duke pasur parasysh se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit (ZPP) ka treguar papërgjegjësi profesionale, duke shkelur Nenin 108A të LPP-së dhe duke mos kthyer përgjigje brenda afateve ligjore, kërkojmë që OSHP-ja, në bazë të kompetencave të saj sipas Nenit 131 të LPP-së:

- t'i shqiptojë gjobën maksimale financiare të lejuar me ligj Autoritetit Kontraktues dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit (ZPP) për shkelje flagrante të afateve dhe aplikim të heshtjes administrative;

- t'i dërgojë kërkesë zyrtare Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik (KRPP) për revokimin e menjëhershëm të Certifikatës Profesionale të Prokurimit të Zyrtarit Përgjegjës për këtë aktivitet, për shkak të shkeljes së rëndë dhe të qëllimshme të parimeve të transparencës dhe trajtimit të barabartë;

- të njoftohet menaxhmenti i lartë i Autoritetit Kontraktues për fillimin e procedurave disiplinore ndaj personave përgjegjës, të cilët me mosveprimet e tyre po shkaktojnë dëme në buxhetin e komunës dhe po pengojnë zhvillimin e rregullt të procedurave të prokurimit publik.

Andaj, kërkojmë që, në përputhje me dispozitat e lartcekura të LPP-së, të hiqen kriteret diskriminuese teknike të përzgjedhjes të përmendura më sipër, të cilat janë përfshirë në njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe të zgjatet afati për dorëzimin e ofertave.

Në të kundërtën, do të jemi të detyruar të paraqesim ankesë në OSHP dhe të njoftojmë edhe organet e tjera kompetente.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 21/05/2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0328/2026, ndërsa me datë 01/06/2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0328 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “HM Home” SH.P.K. eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2026/0328 ka vlerësuar si në vijim:

Raporti i ekspertizës për ankesë me numër: 0328/2026

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin Për Kontratë në e-prokurimit më 28.04.2026

OE HM Home SH.P.K. Ka bërë Kërkesë Për Rishqyrtim më 13.05.2026 në e-prokurim ora 19:51

Vendim mbi Pezullimin e aktivitetit të prokurimit në e-prokurim më 14.05.2026

Ankesa në OSHP më 19.05.2026

Vendimi i Kërkesës Për Rishqyrtim më 20.05.2026

Vendim mbi Pezullimin e aktivitetit të prokurimit në e-prokurim më 21.05.2026

Përgjigje në pretendimin ankimor 1

OE Ankues pretendon që AK ka vendos kritere diskriminuese e nj? ndër to është edhe kriteri:

Pra tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 qe me rastin

2.OE ofertues duhet te caktoj nje Menaxher te projektit i cili duhet te jete dizajner i Enterierit Inxhinier i diplomuar. ose Master – 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Ku OE ankues kërkon që të largohet ky kriter i DT.

Eksperti shqyrtues vleron se kriteri i dosjes së tenderit për menagjer është në përputhje me natyrën e aktivitetit të prokurimit pasi që ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë jo vetëm me furnizim por dhe montimin e tyre. Menaxheri i projektit ka të bëjë me menagjimin e kontratës. Eksperti shqyrtues duke i analizuar specifikimet e dosjes së tenderit ku janë mbi 50 pozicione të ndryshme në dosjen e tenderit për furnizim dhe montim, eksperti shqyrtues vleron se kërkesa e Dosjes së tenderit është e arsyeshme.

Eksperti shqyrtues vleron se pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

Kërkesa e dosjes së tenderit . 3. OE ofertues duhet të ketë një Inxhinier të diplomuar të Emergjencave ose master me se paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit, i cili duhet të jetë i certifikuar si Ekspert për siguri në punë dhe mbretje nga zjarri.

OE kërkon që kjo kërkesë duhet të largohet si kriter i dosjes së tenderit

Eksperti shqyrtues vleron se kjo kërkesë ka të bëjë me kualifikimin profesional të stafit teknik. Qëllimi i një kërkesë të tillë është që të sigurohet që kompania ka staf apo person profesional i cili menagjon sigurinë e puntorëve, menagjimin e procedurave emergjente, dhe mbrojtjen kundër zjarrit. Duke marrë parasysh natyrën e aktivitetit të prokurimit që ka të bëjë me furnizim dhe montim të inventarit eksperti shqyrtues vleron se një kërkesë e Autoriteti Kontraktues është e arsyeshme dhe në përputhje me nenin 69 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron gjithashtu se inventari i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues i furnizimit dhe montimit ka edhe pjesë elektrike si p.sh. të specifikuara teknike por edhe në përshkrim të cmimeve është Furnizimi, blerja dhe montimi i Bojlerit 10litra, me të gjitha elementet përcjellëse (bulonat me tiplla për shtangimin në muri, gypat, etj).

Eksperti shqyrtues vleron se kërkesa e AK-së është e arsyeshme dhe pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3

Kërkesa e dosjes së tenderit: 4. OE Ofertues duhet të ketë se paku pesëmbëdhjetë (15) punëtorë tjerë ndihmës të angazhuar për këtë projekt të trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë. Certifikatat Valide dhe 5 të tjerë për mbrojtje nga zjarri, Certifikatat Valide.

Ky kriter ka të bëjë me kërkesat për kapacitet profesional dhe teknik të operatorit ekonomik (OE) në aspektin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes nga zjarri gjatë realizimit të projektit.

Praktikisht, autoriteti kontraktues ka kërkuar që kompania: të ketë minimum 15 punëtorë ndihmës të trajnuar për: mbrojtje dhe siguri në punë; me certifikata valide; dhe 5 persona të trajnuar për: mbrojtje nga zjarri; gjithashtu me certifikata valide .

Eksperti shqyrtues vleron se kriteri i dosjes së tenderit është i arsyeshëm duke marrë parasysh natyrën e aktivitetit të prokurimit ku qdo aktivitet i prokurimit dhe kriteret e dosjes së tenderit duhet të parashikojnë që duhet të ketë ulje të rrezikut të aksidenteve në punë; respektimi i ligjit për siguri dhe shëndet në punë; gatishmëria ndaj emergjencave/zjarreve; dhe AK-ja me të drejtë ka kërkuar dëshmi që OE ka staf të mjaftueshëm dhe të përgatitur për realizimin e projektit.

Eksperti shqyrtues vleron se pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigje në pretendimin ankimor 4

Kërkesa e dosjes së tenderit 5.OE duhet te ofroj deshmi nga prodhuesi (opo dileri) per ISO standarte si në vijim ISO 10002 2018 ISO TC 136 ISO 19682 2023 ISO 10204 EN 1335-1 EN 10901 2009+A1 2011 TS EN 10204 2007 TS ISO 21524 2021

Eksperti shqyrtues vleron se kriteri i dosjes së tenderit lidhet me kërkesën që operatori ekonomik (OE) të paraqesë dëshmi nga prodhuesi ose dileri për disa standarde ISO/EN të produkteve që do të furnizohen..

Eksperti shqyrtues i ka analizuar dhe hulumtuar ISO apo standardet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe do ti pasqyroj një nga një elementet e tyre:

ISO 10002 : 2018 menaxhimin e ankesave të klientëve; ; përmirësimin e shërbimit ndaj klientit ky standard eksperti shqyrtues vleron se është i arsyeshë pasi që lidhet me përmirësimin e shërbimeve etj.

ISO TC 136 sigurinë e mobilieve, testimet e qëndrueshmërisë, dimensionet dhe performance për krevate, tavolina, karrige, dyshekë,etj.Edhe standard është në haromni me natyren e aktivitetit të prokurimit.

ISO 19682 2023 përcakton mënyrat e testimit të: stabilitetit, forcës, qëndrueshmërisë së tavolinave dhe deskave. Ky standard përdoret për tavolina zyre,mobile etj.dhe që lidhet drejtëpërdrejt me natyren e aktivitetit të prokurimit,

ISO 10204 domethënë certifikatat/material test certificates për çelik, inox, tuba, profile metalike pasi te specifikimet teknike AK-ja ka kërkuar edhe invertat me materiale metalike eksperti shqyrtues vleron se është një standart i arsyeshëm,

EN 1335-1 ka të bëjë dimensionet ergonomike të karrigeve të zyrës, lartësinë e ulëses, mbështetësen e shpinës, mbështetëset e duarve, rregullimet , dhe mënyrën e matjes/testimit të tyre. eksperti shqyrtues vleron se është një standart i arsyeshëm dhe në harmoni me natyren e aktivitetit të prokurimit

EN 10901 2009+A1 2011 është standard evropian për certifikimin e konstruksioneve prej çeliku dhe alumini, kontrollin e prodhimit në fabrikë , saldimin dhe gjurmueshmërinë, e që eksperti shqyrtues vleron se është në harmoni me natyren e aktivitetit të prokurimit

TS EN 10204 2007 është standard që përcakton llojet e dokumenteve të inspektimit dhe certifikatave të materialit për produktet metalike, eksperti shqyrtues vleron se është në harmoni me natyren e aktivitetit të prokurimit

TS ISO 21524 2021 shtë standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për:projektimin, testimin, klasifikimin, instalimin, dhe mirëmbajtjen e perdeve aktive kundër zjarrit , eksperti shqyrtues vleron se është në harmoni me natyren e aktivitetit të prokurimit pasi që edhe inventari përshinë edhe furnizimin me perde dhe montimin e tyre.

Duke u bazuar në hulumtimin e standardeve të kërkuara eksperti shqyrtues vleron se pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5

Kërkesa e dosjes së tenderit 6. OE ofertues duhet të posedoj 1. Kamion transportues, 2. Furgon transportues, 2. Pickup

6. Lista e Pajisjeve, mjeteve, makinave teknike, mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve, pajisjeve teknike dhe kapacitetet tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit). Lista paisjeve dhe mjeteve, makinave teknike të OE duhet të jetë origjinale , e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik, duhet të ofroj si dëshmi, Fotografi , Specifikacion teknik, Libreza, për paisjet që nuk regjistohen të deshmohen me dud doganor të noterizuar ose Faturë

Eksperti shqyrtues vleron se kriteri i dosjes së tenderit ku Autoriteti kontraktues ka kërkuar që kompania të ketë kapacitet për transport dhe shpërndarje të mallrave, pra: me kamion për ngarkesa më të mëdha (p.sh. inventar, pajisje); me furgon për dërgesa më të vogla; me pickup për lëvizje fleksibile në terren (p.sh. montim, transport i shpejtë). Duke marr parasysh natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe vëllimin-sasinë e furnizimit eksperti shqyrtues vleron se AK-ja me të drejtë ka kërkuar një kapacitet të till.

Eksperti shqyrtues vleron se pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 6

Kërkesa e dosjes së tenderit 8. OE ofertues duhet të sjellë Planin Dinamik, të detajuar për secilin pozicion.

Eksperti shqyrtues vleron se kriteri i dosjes së tenderit është i arsyeshëm pasi aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me furnizim dhe montim dhe jo siq pretendon OE ankues se kemi të bëjmë vetëm me furnizim.

Eksperti shqyrtues vleron se pretendimi ankimor është i pa bazuar

Eksperti shqyrtues vleron se Autoriteti Kontraktues me të drejtë ka vendos kritere serioze me të cilat synon lidhjen e kontrates me një OE i cili është i përgjegjshëm, serioz me përvojë dhe i cili i përgjigjet nevojave dhe kërkesve të Autoritetit Kontraktues.

Eksperti shqyrtues sqaron për OE se nëse një OE nuk ka kapacitete teknike ose profesionale mund të mbështetet edhe te OE të tjerë ashtu siq e lejon LPP-ja duke krijuar grupin e operatoreve ekonomik (konzorciumet) duke ofertuar së bashku si GOE.

Përgjigje në pretendimin ankimor 8

Gjithashtu OE ankues pretendon që ky aktivitet i prokurimit do të duhet të zhvillohet nga AQP-ja përmes mini-konkurrencës nga kontrata ekzistuese e AQP-së.

Eksperti shqyrtues ka kërkuar nga AQP-ja me e-mail dërgimin e kontratës ekzistuese që ka të bëjë me furnizim me inventar (mobile) më 25.05.2026 dhe AQP-ja marrveshjen korniz-furnizim me mobilje më ka dërguar në e-mail po më 25.05.2026.

Eksperti shqyrtues ka krahasuar specifikat -pozicionet (produktet) dhe ka konstatuar se shumica e pozicioneve- produkteve të cilat AK-ja i ka në këtë aktivitet të prokurimit nuk janë të njëja me

kontraten ekzistuese të AQP-së.

Eksperti shqyrtues gjithashtu sqaron se OE Ankues nuk është në listen e AQP-së pra në kontraten ekzistuese me numer të prokurimit: UA/2016-25-1659-1-1-1 të nënshkruar dhe protokolluar më 21.07.2025. Andaj nuk kuptohet interesi i OE ankues ku kërkon që AQP-ja të zhvillon këtë aktivitet të prokurimit me kontratën ekzistuese kur vet nuk është në atë kontratë.

Eksperti shqyrtues vleron se pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigje në pretendimin ankimor 8

Sa i përket Kërkesës Për Rishqyrtim dhe mos përgjigjen e AK-së ku OE ankues ka kërkuar ndëshkimin dhe sanksionimin e zyrtarit përgjegjës të prokurimit eksperti shqyrtues sqaron si në vijim:

OE ankues ka bërë Kërkesë Për Rishqyrtim më 13.05.2026 ora 19:51 konform afateve ligjore të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues ka pezulluar aktivitetin e prokurimit më 14.05.2026.

Ankesa në OSHP më 19.05.2026

Vendimi i Kërkesës Për Rishqyrtim më 20.05.2026

Vendim mbi Pezullimin e aktivitetit të prokurimit në e-prokurim më 21.05.2026

Në vijim e keni Interpretimin e KRPP-së

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar lidhur me kalkulimin e afatit kohor për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim, KRPP ofron interpretimin ligjor, si në vijim

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Kukulimin e afateve kohore të përcaktuar me këtë ligj, e rregullon neni 5 i LPP-së.

Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni përcaktojnë:

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Neni 108/A

Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja ka kthyer përgjigje ndaj Kërkesës Për Rishqyrtim brenda 5 dite pune pasi data e 14.15,18,19 dhe 20 maj 2026 kanë qenë ditë punë dhe gjithashtu aktiviteti i prokurimit ka qenë i pezulluar kjo mund të shihet edhe në e-prokurim pra me datë 14.05.2026 pra një ditë pasi që OE ka bërë Kërkesë Për Rishqyrtim.

Eksperti shqyrtues vleron se për deri sa aktiviteti i prokurimit është i pezulluar OE duhet të presin përgjigjjen e Autoritetit Kontraktues.

Eksperti shqyrtues vleron se pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “HM Home” SH.P.K. të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtines i lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit. “Furnizim me inventar ne qendra te ndryshme sociale” me numër të prokurimit: 616-26-2558-1-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - HM Home SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: